



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
KËSHILLI DREJTUES**

**V E N D I M Nr.1,**

**datë 16.02.2023**

**Për**

**“MIRATIMIN E DOKUMENTIT “MBI DISA SHTESA E NDRYSHIME NË  
RREGULLOREN NR.40, DATË 17.12.2015, “PËR TË DHËNAT STATISTIKORE DHE  
FINANCIARE PERIODIKE MBI SHËRBIMET E OFRUARA NGA OFRUESIT E  
SHËRBIMEVE POSTARE”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z. Tomi	Frashëri	Kryetar
Znj. Edlira	Dvorani	Anëtar
Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
Z. Lorenc	Bako	Anëtar
Znj. Xhoana	Lilaj	Anëtar

dhe sekretare Znj. Hasime Ferati, në mbledhjen e datës 16.02.2023, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullores së Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, miratuar me Vendimin nr.7, datë 16.2.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, me propozim të Grupit të Punës shqyrtoi çështjen me objekt:

***Miratimin e dokumentit: “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr.40, datë 17.12.2015 “Për të Dhënat Statistike dhe Financiare Periodike mbi Shërbimet e Ofruara nga Ofruesit e Shërbimeve Postare”***

**BAZA LIGJORE:**

1. Pika 4 dhe 10, të nenit 9, nenit 38 të Ligjit nr.46/2015 “Për Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë (Ligji nr.46/2015);
2. Pika 3 e nenit 114 të Ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (Ligji nr.9918/2008);

3. Ligj nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” (*Ligji nr. 44/2015*);
4. Neni 13 dhe 14, i Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin nr.7, datë 16.2.2018 të KD të AKEP;
5. Rregullore për Procedurat e Këshillimit Publik, miratuar me vendimin nr.21, datë 7.12.2021.

## **K Ë S H I L L I D R E J T U E S:**

Nga shqyrtimi i materialit shkresor,

- Dokumenti: *Mbi disa shtesa e ndryshime të Rregullores nr.40, datë 17.12.2015 “Për të dhënat statistikore dhe financiare mbi shërbimet e ofruara nga ofruesit e shërbimeve postare”*
- Relacioni shoqërues i projekt-aktit (relacioni);
- Projekt-akti miratues i dokumentit (projekt-vendimi);
- Aneksi 1. Formularët A, “Për ofruesin e Shërbimit Universal Postar” dhe C, “Për Ofruesin e Shërbimeve Postare që nuk bëjnë pjesë në Shërbimin Universal Postar”, të ndryshuar;
- Aneksi 2. “Formularë për t’u plotësuar nga ofruesit e shërbimeve Postare”,

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

## **V Ë R E N:**

1. Rregullorja nr.40, datë 17.12.2015 “*Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga ofruesit e shërbimeve postare*”, është miratuar nga KD e AKEP me Vendim nr.2653, datë 17.12.2015, me qëllim grumbullimin, evidentimin dhe përdorimin e të dhënave statistikore dhe financiare mbi shërbimet postare, për të nxjerrë përfundimet e nevojshme për analizën dhe tendencat e zhvillimit në tregun postar si dhe përcaktimin e treguesve matës të sektorit postar. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i të dhënave statistikore dhe financiare periodike për shërbimet postare të ofruara nga ofruesit e shërbimeve postare, si dhe përcaktimi i procedurave dhe rregullave për plotësimin dhe dërgimin e formularëve me të dhënat e kërkuara.
2. Udhëzimi nr. 5 datë 25.6.2021, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë “*Për miratimin e rregullave mbi shërbimet e dërgesave të pakove postare ndërkuftare*”, i publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 110, datë 12.7.2021, përcakton ndër të tjera se të gjithë ofruesit e shërbimeve të dërgesave të pakove ndërkuftare, përjashtuar ofruesit e parashikuar në pikën 5, të nenit 3, brenda datës 31 janar të çdo viti kalendarik, vënë në dispozicion të AKEP listën publike të tarifave të zbatueshme nga data 1 janar e çdo viti kalendarik, për dërgesat e çdo objekti të vetëm postar, përveç objekteve të korrespondencës, që bëjnë pjesë në kategoritë e listuara në aneksin 1.

AKEP, brenda datës **28 shkurt** të çdo viti kalendarik, publikon të dhënat për tarifatat e shërbimeve të dërgesave ndërkufitare për pakot e ofruara nga ofruesit e shërbimeve, duke siguruar që publikimi bëhet në një link të dedikuar të faqes së AKEP, i cili do jetë neutral dhe jo me karakter tregtar.

3. Konform dhe në zbatim të udhëzimit të lartpërmendur, do të realizohen ndryshimet e nevojshme në formularët A, *“Për ofruesin e Shërbimit Universal Postar”* dhe C, *“Për Ofruesin e Shërbimeve Postare që nuk bëjnë pjesë në Shërbimin Universal Postar”*, të Aneksit nr. 1 të Rregullores nr. 40 datë 17.12.2015, *“Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga ofruesit e shërbimeve postare”*, duke shtuar disa emërtime të dhënash shtesë që sipërmarrës të caktuar të shërbimit postar do të përcjellin pranë AKEP, konform emërtimeve të listuara në formularët përkatës, si dhe të shtohet Aneksi nr.2 *“Formularë për t’u plotësuar nga ofruesit e shërbimeve Postare”*.
4. Sa më sipër, KD i AKEP vlerëson se do të rrisë në nivele domethënëse veprimtarinë e institucionit sa i përket;
  - publikimit të raporteve periodike të plota që evidentojnë treguesit kryesorë të zhvillimit të tregut postar;
  - nxjerrjes së përfundimeve të nevojshme për analizën e situatës dhe tendencave të zhvillimit të tregut postar;
  - mbikëqyrjen dhe monitorimin e vazhdueshëm të tregut të shërbimeve postare në Shqipëri, me qëllim plotësimin e objektivave rregullatore, si dhe politikës sektoriale postare.
5. Ndryshimet e akteve në fjalë, KD i AKEP i vlerëson në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator, pika 10, e Nenit 9, *“Kompetencat e AKEP për rregullimin postar”* dhe Nenit 38 *“Detyrimi për të dhënë informacion”*, të Ligjit nr. 46 datë 7.5.2015, *“Për shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”*.
6. Në zbatim të Ligjit nr 46/2015, *“Për Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”* dhe në përputhje me Rregulloren për Procedurat e Njoftimit dhe Këshillimit Publik, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP, nr. 21 datë 7.12.2021, KD i AKEP, ndërmori procedurat e nevojshme sa i përket nxjerrjes për Këshillim Publik të ndryshimit të formularëve A, *“Për ofruesin e Shërbimit Universal Postar”* dhe C, *“Për Ofruesin e Shërbimeve Postare që nuk bëjnë pjesë në Shërbimin Universal Postar”*, të Aneksit nr. 1 të Rregullores nr. 40 datë 17.12.2015, *“Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga ofruesit e shërbimeve postare”* si dhe të shtohet Aneksi nr.2 *“Formularë për t’u plotësuar nga ofruesit e shërbimeve Postare”*, duke ezauruar procesin e këshillimit publik me palët e interesuara.
7. Në përputhje me përcaktimet e ligjit 46/2015 dhe Rregulloren e AKEP Procedurat e Njoftimit dhe Këshillimit Publik miratuar me VKD nr. 21 datë 7.12.2021, Këshillit Drejtues i AKEP Vendim Nr.13, datë 18.10.2022 miratoi për këshillim publik dokumentin: *“Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr.40, datë 17.12.2015 “Për të Dhënat Statistikore dhe Financiare Periodike mbi Shërbimet e Ofruara nga Ofruesit e Shërbimeve Postare”*. Afati për kryerjen e këshillimit Publik ishte 20 ditë pune nga data e njoftimit të dokumentit në faqen zyrtare të AKEP, [www.akep.al](http://www.akep.al).
8. Pas përfundimit të periudhës së këshillimit publik me palët e interesuara, AKEP ka hartuar dokumentin përfundimtar *“Mbi disa shtesa e ndryshime të Rregullores nr. 40 datë*

17.12.2015, “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga ofruesit e shërbimeve postare” si dhe të shtohet Aneksi nr.2 “Formularë për t’u plotësuar nga ofruesit e shërbimeve Postare”, i cili sintetizon ndryshimet e referuara në dokumentin për këshillim publik.

9. Ky dokument:

- a. përbën një dokument të rëndësishëm rregullator i cili shërben për përgatitjen e të dhënave dhe serive kohore për kryerjen e analizave përkatëse, të cilat janë shumë të rëndësishme për zhvillimet rregullatore dhe tregun e shërbimeve postare në Shqipëri;
- b. nga pikëpamja e ligjshmërisë është në konformitet me përcaktimet ligjore të parashikuara në ligjin nr. 46/2015, “Për Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”.

### **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

1. Në mbështetje të Pikës 4 dhe 10, të Nenit 9 dhe Nenit 38 të Ligjit nr 46/2015 “Për Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë (Ligji nr.46/2015);

### **V E N D O S :**

1. Të miratojë dokumentin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr.40, datë 17.12.2015 “Për të Dhënat Statistikore dhe Financiare Periodike mbi Shërbimet e Ofruara nga Ofruesit e Shërbimeve Postare””.
2. Ky Vendim dhe Dokumenti “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr. 40 datë 17.12.2015 “Për të Dhënat Statistikore dhe Financiare Periodike mbi Shërbimet e Ofruara nga Ofruesit e Shërbimeve Postare””, publikohet në faqen zyrtare të AKEP, [www.akep.al](http://www.akep.al).
3. Ngarkohet Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullatore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetar**

**Anëtar**

**Anëtar**

**Anëtar**

**Anëtar**

**Tomi Frashëri**

**Edlira Dvorani**

**Ketrin Topçiu**

**Lorenc Bako**

**Xhoana Lilaj**



**MBI DISA SHTESA E NDRYSHIME  
TË RREGULLORES NR.40, DATË  
17.12.2015**

**“PËR TË DHËNAT STATISTIKORE DHE FINANCIARE PERIODIKE MBI  
SHËRBIMET E OFRUARA NGA OFRUESIT E SHËRBIMEVE POSTARE”**

**Dokument Përfundimtar**

(MIRATUAR ME VKD NR. 1, DATË 16.02.2023)

## **KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

### **Neni 1 Objekti**

Objekti i kësaj rregullore është përcaktimi i të dhënave statistikore dhe financiare periodike për shërbimet postare të ofruara nga ofruesit e shërbimeve postare, si dhe përcaktimi i procedurave dhe rregullave për plotësimin dhe dërgimin e formulareve me të dhënat e kërkuara.

### **Neni 2 Qëllimi**

Grumbullimi, evidentimi dhe përdorimi i të dhënave statistikore dhe financiare mbi shërbimet postare, për të nxjerrë përfundimet e nevojshme për analizën dhe tendencat e zhvillimit në tregun postar si dhe përcaktimin e treguesve matës të sektorit postar.

### **Neni 3 Baza ligjore**

Pika 10 e nenit 9 dhe neni 38 të ligjit nr.46, datë 07.05.2015 “Për shërbimin Postar në Republikën e Shqipërisë”.

### **Neni 4 Fusha e zbatimit**

Dispozitat e kësaj rregulloreje janë të detyrueshme për tu zbatuar nga të gjithë ofruesit e shërbimeve postare të pajisur nga AKEP me Autorizim Individual dhe/ose Autorizim të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare, të cilët bëjnë pjesë në regjistrin e publikuar në faqen zyrtare të AKEP, [www.akep.al](http://www.akep.al).

### **Neni 5 Përcaktime**

Termet e përdorura në këtë Rregullore do të kenë të njëjtin kuptim si në ligjin nr.46, datë 07.05.2015 “Për shërbimin Postar në Republikën e Shqipërisë”, dhe në rast se nuk janë të përkufizuar në ligj, do të jenë në përputhje me direktivat e BE për shërbimet postare dhe aktet e UPU në fuqi.

## KREU II

### PROCEDURA DHE KUSHTET E PLOTËSIMIT DHE DËRGIMIT TË TË DHËNAVE STATISTIKORE POSTARE

#### Neni 6

#### Detyrimet për plotësimin dhe dërgimin e të dhënave

1. Çdo ofrues i shërbimeve postare, i përcaktuar sipas nenit 4 të kësaj rregulloreje, është i detyruar të plotësojë dhe dërgojë në formë shkresore dhe në modulin e aplikimeve online formularët me të dhënat e kërkuara sipas procedurave, kërkesave dhe afateve të përcaktuara në këtë rregullore.
2. Formularët me të dhënat statistikore dhe financiare postare plotësohen në Modulin e Aplikimeve Online, në faqen e internetit të AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al).
3. AKEP mund të kërkojë të dhëna shtesë, të cilat nuk janë të specifikuar në formularë, nëpërmjet njoftimeve në formë shkresore dhe/ose në rrugë elektronike, në të cilat përcaktohet lloji, afatet për dërgimin e të dhënave si dhe qëllimi i kërkesës.

#### Neni 7

#### Formularët dhe mënyra e raportimit

1. Formularët me të dhënat statistikore dhe financiare periodike, që duhet të plotësojnë dhe dërgojnë ofruesit e shërbimeve postare, janë pjesë e kësaj rregulloreje, të cilët janë të emërtuara si më poshtë:
  - 1.1 Për Ofruesin e Shërbimit Universal Postar:
    - a) **Formulari A** - Përmban të dhëna statistikore dhe financiare vjetore për shërbimet postare, të cilat duhet të plotësohen dhe dërgohen nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar;
    - b) **Formulari B** - Përmban të dhëna statistikore tre mujore për shërbimet postare, të cilat duhet të plotësohen dhe dërgohen nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar.
  - 1.2 Për Ofruesit e Shërbimeve Postare që nuk bëjnë pjesë në shërbimin universal postar:
    - a) **Formulari C** - Përmban të dhëna statistikore dhe financiare vjetore për shërbimet postare, të cilat duhet të plotësohen dhe dërgohen nga Ofruesit e Shërbimeve Postare;
    - b) **Formulari D** - Përmban të dhëna statistikore tre mujore për shërbimet postare, të cilat duhet të plotësohen dhe dërgohen nga Ofruesit e Shërbimeve Postare.
  - 1.3 Për Ofruesit e Shërbimeve Postare që plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 3 të Udhëzimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë<sup>1</sup>.
    - a) **Aneks 2** - Formularë për t'u plotësuar nga ofruesit e shërbimeve postare.
2. Ofruesi i Shërbimeve Postare ka detyrimin që për çdo periudhë raportimi:
  - a) Të shkarkojë lokalisht nga moduli on-line i AKEP Formularët përkatës në varësi të shërbimeve që ofron sipas përcaktimeve të dhëna në Formularët respektive.
  - b) Të plotësojë formularët përkatës sipas udhëzimeve në këtë rregullore për afatet e raportimit dhe sipas përshkrimeve të dhëna në formularët e treguesve.

<sup>1</sup> <https://www.infrastruktura.gov.al/wp-content/uploads/2021/11/udhezim-2021-06-25-5.pdf>

- c) Të ngarkojë formularët e plotësuar në modulën on-line të AKEP.
3. Për përdorimin e modulit on-line të AKEP, Ofruesi i Shërbimeve Postare mund të përdorë ndihmesën që ofrohet në Menunë e Modulit On-line: “Manuale të nevojshme” në zërin “Raportime Formularësh”.

## **Neni 8**

### **Afatet e dërgimit të të dhënave**

1. Të dhënat e kërkuara sipas formularëve të specifikuar në nenin 7 të kësaj rregulloreje duhet të dërgohen në AKEP sipas përcaktimeve:
- a) **Formulari A, Formulari C dhe Aneks 2**, të plotësuar me të dhënat dhe treguesit postare vjetore, për periudhën nga data 1 Janar deri në datën 31 Dhjetor, pa përfshirë të dhënat financiare, dërgohen deri në datën 31 Janar të vitit pasardhës, ndërsa të plotësuar me të dhënat financiare dërgohen deri në datën 10 Prill të vitit pasardhës.
  - b) **Formulari B dhe Formulari D**, të plotësuar me të dhënat dhe treguesit postare për çdo tre muaj dërgohen deri në datën 20 të muajit pasardhës të tremujorit respektiv.

## **KREU III**

### **VERIFIKIMI DHE PËRDORIMI I TË DHËNAVE**

## **Neni 9**

### **Verifikimi i të dhënave nga AKEP**

1. AKEP, jep konfirmimin, nëse të dhënat e dërguara nga operatori ose ofruesi i shërbimeve postare janë në përputhje të plotë me kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore.
- Konfirmimi bëhet me shkrim ose online brenda 7 (shtatë) ditëve nga data që janë dërguar në AKEP, të dhënat e plota dhe të sakta siapas kërkesave të rregullores.
2. Nëse AKEP, konstaton parregullsi në plotësimin dhe dërgimin e formularëve, ose të dhënat statistikore postare nuk janë të plota dhe të sakta, brenda 7 (shtatë) ditëve nga depozitimi i të dhënave, i kërkon ofruesit të shërbimeve postare dërgimin e plotë dhe të saktë të të dhënave.
- Ridërgimi i të dhënave duhet të bëhet brenda 5 (pesë) ditëve, pas marrjes së njoftimit nga AKEP.
3. AKEP, mund të kryejë verifikime të saktësisë të të dhënave të dërguara nga ofruesi i shërbimeve postare, nëpërmjet inspektimit të dokumentacionit në ambjentet e tyre.

## **Neni 10**

### **Përdorimi i të dhënave nga AKEP**



1. AKEP, do të bëjë përpunimin dhe analizën e të dhënave statistikore të dërguara nga ofruesit e shërbimeve postare, të cilat do të shërbejnë për:

- a) Mbikqyrjen dhe monitorimin e vazhdueshëm të tregut të shërbimeve postare në Shqipëri, me qëllim plotësimin e objektivave rregullatore si dhe politikës sektoriale postare;
- b) Nxjerrjen e përfundimeve të nevojshme për analizën e situatës dhe tendencave të zhvillimit të tregut postar;
- c) Publikimin e raporteve periodike që evidentojnë treguesit kryesore të zhvillimit të tregut postar;
- d) Informimin e institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare, të interesuar për zhvillimin e tregut postar në Shqipëri.

### **Neni 11**

#### **Publikimi i të dhënave**

1. Të dhënat tre-mujore publikohen nga AKEP brenda 15 ditëve nga afati i depozitimit të të dhënave nga ofruesit e shërbimeve postare;
2. Të dhënat vjetore publikohen nga AKEP brenda muajit Prill të vitit pas-ardhës.
3. AKEP, zbaton parimin e kofidencialitetit në publikimin dhe përdorimin e të dhënave të tregut të shërbimeve postare, në zbatim të ligjit.

### **KREU IV**

#### **KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE**

### **Neni 12**

#### **Sanksionet**

Mosrespektimi i detyrimeve të përcaktuara në këtë rregullore, nga ofruesit e shërbimeve postare, përbën shkelje të nenit 38 të ligjit nr.46, datë 07.05.2015 dhe konsiderohet kundërvajtje administrative sipas dispozitave të parashikuara në ligjin 46/2015

### **KREU V**

#### **DISPOZITA TË FUNDIT**

### **Neni 13**

#### **Shfuqizimi**

Rregullorja Nr.28 datë 28.12.2012 “Për të dhënat statistikore dhe financiare mbi shërbimet e ofruara nga operatorët dhe ofruesit e shërbimeve postare” miratuar me Vendim Nr.2231, datë 28.12.2012, të Këshillit Drejtues të AKEP, shfuqizohet.

### **Neni 14**

#### **Hyrja në Fuqi**

Kjo rregullore dhe Anekset e saj, hyjnë në fuqi në datën e miratimit nga KD i AKEP-it dhe publikohet në faqen e internetit të AKEP.

**Aneks 1: Formularët e të dhënave të shërbimeve postare**

Ndryshimet në Formularët e treguesve statistikore/financiare, në format Exel, bashkangjitur.

**Aneks 2: Formularë për t'u plotësuar nga ofruesit e shërbimeve postare**